Kronikë

Shkodër, vëllezërit shfrytëzonin si 'skllav' adoleshentin afgan në servisin e tyre, arrestohet njëri tjetri në kërkim

Një 16 vjeçar nga Afganistani që mbahej me forcë dhe shfrytëzohej për punë është arritur të shpëtohej, ndërsa policia ka arrestuar njërin prej shfrytëzuesve dhe ka shpallur në kërkim të vëllanë.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
14 Tetor, 10:21 | **Përditesimi: 14 Tetor, 10:30**

Share

Shkoder- Një 16 vjeçar nga Afganistani që mbahej me forcë dhe shfrytëzohej për punë është arritur të shpëtohej, ndërsa policia ka arrestuar njërin prej shfrytëzuesve dhe ka shpallur në kërkim të vëllanë.

Ngjarjaka ndodhur në fshatin Berdicë e Mesme në Shkodër. Adoleshenti që dyshohet se ishte i trafikuar ishte detyruar të punonte në servisin e vëllezërve.

Policia ka vënë në pranga Alehandro Pashuku dhe u shpall në kërkim I vëllai Kristjan Pashuku.



LEXO EDHE:
E ngarkuara me Punë e SHBA vizitë në Kalanë e Rozafës, njihet me historinë e Shkodrës

Njoftimi i policise

Mbanin me forcë një fëmijë të mitur 16-vjeçar, nga Afganistani (i dyshuar i trafikuar), për ta shfrytëzuar për punë, Policia vë në pranga një 18-vjeçar dhe shpall në kërkim vëllanë e tij. Gjithashtu, procedohen në gjendje të lirë vëllai tjetër dhe babai i këtyre shtetasve.

Gjatë kontrollit në servis, Policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri automatik, një armë zjarri pistoletë imituese zhurme, një armë sportive pneumatike dhe municion luftarak.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcës së Posaçme "Shqiponja", pas informacionit të marrë nga Interpol Tirana, për një minoren nga Afganistani, që mbahej me forcë, në një servis në fshatin Berdicë e Mesme, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Minoreni".

Në kuadër të operacionit u bë e mundur gjetja e minorenit, në gjendje të mirë shëndetësore.

Gjithashtu:

-u arrestua në flagrancë shtetasi A. P., 18 vjeç, banues në fshatin Berdicë e Mesme, Shkodër, për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit";

-u shpall në kërkim shtetasi K. P., 33 vjeç (vëllai i 18-vjeçarit të arrestuar) banues në fshatin Bërdicë, për veprën penale "Trafikim i të mituve";

-u proceduan në gjendje të lirë shtetasit L. P., 31 vjeç dhe A. P., 57 vjeç (vëllai tjetër dhe babai i 18-vjeçarit të arrestuar), të dy banues në fshatin Berdicë, për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Kontrabanda me mallra të tjera".

Gjatë kontrollit të ushtruar në servisin në pronësi të këtyre shtetasve, Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një armë zjarri automatik, një armë zjarri pistoletë imituese zhurme, një armë sportive pneumatike dhe municion luftarak.

Në drejtimin e Prokurorisë, vijon puna për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë ligjor të rastit, si dhe për kapjen e arrestimin e personave të tjerë të përfshirë në të.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Lajmi ne perditesim...

S.G/I.M/Shqiptarja.com

TAG: Kristjan Pashuku | Shkoder

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Krijohet dhe 'Djathtas', a do i mbështesni partitë e reja në 2025?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Shkodër/ Djali i ish-kandidatit të PD për kryebashkiak denoncon në polici: Dy persona me motor më drejtuan armën tek pedonalja
11 Tetor, 13:34

Shkodër, ambasadorët marrin pjesë në marshim sensibilizues për parandalimin e kancerit të gjirit
Ergys Kavaja
10 Tetor, 16:22

'Rally Vintage', parada e veçantë në Shkodër me makina ikonike, të ardhura nga mbarë Europa
Ergys Kavaja
9 Tetor, 14:24

Shkodër/ Rrugët e mbushura me ujë nga reshjet, pas disa orësh rikthehet normalitetit! Parashikimi për 3 ditët e ardhshme, Beci: Edhe nesër shi
Ergys Kavaja
9 Tetor, 12:32

Nesër reshje në Shkodër e Lezhë, tre ministra dakordësojnë masat parandaluese me kryebashkiakët: Inspektoni hidrovoret dhe pastroni kanalet
8 Tetor, 21:18

Shkodër, volejbollistja kanadeze e Vllaznisë zgjedh të jetojë në konviktin e studentëve: Kushte të mira
Ergys Kavaja
8 Tetor, 18:08

Studentët preferojnë Infermieri, Ekonomik, Inxhinieri! Mësuesitë në pikën kritike, Rektorët: Duhet't'i reformojmë!
7 Tetor, 15:47

Shkodër/ Arrestohet një rumun, i vodhi me dhunë portofolin dhe celularin një adoleshenti! Gjatë kontrollit iu gjet dhe një sasi kanabis (EMRI)
7 Tetor, 12:00

'Veri Jug' në Beltojë dhe Kosmaç, dy fshatra si oaze paqeje! Fermeri kthehet nga emigrimi dhe investon në tokat e familjes
6 Tetor, 14:44

Sofra pukjane bën bashkë të larguarit që nuk e harrojnë vendlindjen
6 Tetor, 12:52

Pukë/ I shpallur në kërkim për kultivim të bimëve narkotike, arrestohet në Morinë 33-vjeçari! Po tentonte të hynte në vend
5 Tetor, 12:51

Shkodër/ Hapet tenderi 11 milion euro për Uren e Bahcallekut deri tek harku i Bërdicës
4 Tetor, 20:14

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje